

VENDIM
Nr. 130, datë 16.3.1997

PËR FURNIZIMIN ME KARBURANTE

Me qëllim që të normalizohet furnizimi me karburante, me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kombinati i përpunimit të thellë të naftës në Ballsh dhe uzina e përpunimit të naftës në Fier të vihen menjëherë nën kontrollin e organeve të policisë dhe të mbahen në ruajtje si objekte të rëndësishme shtetërore.

2. Të vihen gjithashtu në ruajtje si objekte të rëndësishme shtetërore të gjitha depot e karburanteve nëpër rrethe dhe pikat e shitjes me pakicë të karburanteve të Albpetrolit.

3. Prodhimi i karburanteve, vajgurit dhe solarit në Ballsh dhe shpërndarja e tyre të bëhet sipas një programi që do të hartojë Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike për të plotësuar nevojat e rendit, të ushtrisë, të administratës shtetërore qendrore e lokale etj.

4. Shpërndarja e karburanteve nga Ballshi të bëhet me hekurudhë, duke e shoqëruar me forca të armatosura, si dhe me automjetet e rezervës së shtetit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Brendshme, Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino